LIGJ
Nr. 109/2016

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 031, DATË 11.12.2008,"PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat", të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Neni 47 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 47
Tarifat fikse të veprimeve përmbarimore

Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, paguhet tarifa fikse.

Masa e tarifës fikse caktohet duke mbajtur në konsideratë vlerën dhe llojin e detyrimit, si dhe kompleksitetin e veprimit procedural përmbarimor.

Masa e tarifës fikse të veprimit përmbarimor, llojet e veprimeve përmbarimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit te Financave, pasi merret dhe mendimi i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësore Privatë.".

Neni 2

Neni 48 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 48
Tarifa e suksesit

Përmbaruesi gjyqësor privat përfiton një tarifë suksesi, e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindjeje të caktuar mbi vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Masa e tarifës së suksesit caktohet në marrëveshjen mes kreditorit dhe përmbaruesit gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave përcaktojnë me udhëzim të përbashkët nivelin minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.".

Neni 3
Aktet në nënligjore

Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet e përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Deri në miratimin e akteve të reja nënligjore do të zbatohen tarifat e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.10.2016

Shpallur me dekretin nr. 9871, datë 21.11.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani